

# RAPORTI VJETOR

AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS



AGJENCIA  
KOMBËTARE  
E DIASPORËS



# RAPORTI VJETOR 2023

RAPORTIMI I AKTIVITETEVE TË  
ZHVILLUARA DHE PASQYRËS FINANCIARE

2023



## Tabela e Përmbajtjes

HYRJE .....	5
OBJEKTIVAT E ARRITURA GJATË VITIT 2023 .....	5
1. AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS.....	6
1.1. ORGANET DREJTUESE.....	6
1.1.1. KËSHILLI DREJTUES .....	6
1.1.2. DREJTORI EKZEKUTIV .....	6
1.2. STRUKTURA ADMINISTRATIVE .....	7
1.2.1. Drejtoria e Diasporës .....	7
1.2.2. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse .....	7
1.2.3. Njësia e Menaxhimit të Projekteve .....	7
2. USHTRIMI I DETYRAVE FUNKSIONALE .....	9
2.1. Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021-2025.....	9
2.2. Këshilli Kordinues i Diasporës .....	10
2.3. SAMITI I TRETË I DIASPORËS .....	12
3. AKTIVITETET E AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS .....	14
3.1. AKTIVITETE ME KOMUNITETET SHQIPTARE.....	14
3.1.1. Aktivitet me rastin e kremtimit të Pavarësisë së Kosovës organizuar nga komuniteti shqiptar në Zvicër, në datë 18 shkurt 2023 .....	14
3.1.2. Aktivitet me rastin e kremtimit të Pavarësisë së Kosovës organizuar nga komuniteti shqiptar në Mbretërinë e Bashkuar në datë 19 shkurt 2023, në Londër.....	15
3.1.3. Aktivitet organizuar nga komuniteti arbëresh në rajonin Kalabrisë.....	16
3.1.4. Aktivitetit kulturor organizuar nga shoqata “Ardhmëria” me rastin e Festës së Fëmijëve, në datë 11 qershor 2023, në Londër.....	17
3.1.5. Festivali Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës datë 24-30 qershor 2023.....	17
3.1.6. Aktivitet me komunitetin Arbëresh në Piana degli Albanesi, rajoni i Siçilsë në datë 29-30 gusht 2023 .....	18
3.1.7. Aktivitet me komunitetin Arbëresh në Piana degli Albanesi, rajoni i Siçilsë në date 22-23 Shtator 2023.....	19
3.1.8. Tryezë e Rrumbullakët “Emigrimi në Mbretërinë e Bashkuar, një guidë drejt rrugëve ligjore” në datat 10 dhe 13 nëntor 2023 në Bashkinë Kukës dhe Universitetin Qiriazi në Kamëz. ....	20
3.1.9. Aktivitet me komunitetin shqiptar në Zvicër.....	20
3.1.10. Konferencë organizuar nga OSCE Prezenca në Shqipëri me objekt projekti “Mbështetje për reformën zgjedhore në Shqipëri” në datë 17 Tetor 2023, në Tiranë.....	21
3.1.11. Java Ndërkombëtare e Sipërmarrjes (GEW) .....	22
3.1.12. Aktivitet me komunitetin shqiptar në Gjermani.....	22
4. DATABAZA E STUDENTËVE .....	22



5. MEMORANDUME BASHKËPUNIMI .....	23
6. BOTIME .....	23
6.1. DIASPORA SHQIPTARE NDËR VITE .....	23
7. PUBLIKIME .....	24
7.1. BULETINI I MASAVE TË PLANIT TË VEPRIMIT .....	24
7.2. NEWSLETTER PËR DIASPORËN .....	24
8. RAPORTIM DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE .....	25
8.1. ANALIZË FINANCIARE JANAR-DHJETOR 2023 .....	25
8.2. Realizimi .....	26
TABELA E BUXHETIT DHE REALIZIMI (PLAN-FAKT) .....	27
Në tabelën e mëposhtme paraqiten detajimi i shpenzimeve korrente me elementet përbërës të tyre. ....	27
8.2.1. për Fondin e pagave dhe sigurimeve (Ilogaria ekonomike 600,601) .....	27
8.2.2. Shpenzimet Korrente (mallra dhe shërbime, Ilogaria ekonomike 602) .....	28
8.2.3. Shpenzime kapitale (Ilogaria ekonomike 231) .....	29
8.2.4. Fond i veçantë (Ilogaria ekonomike 606) .....	29
8.3. DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE (FUNKSIONIMI) .....	29
8.3.1. Financa .....	29
8.3.2. Burime Njerëzore .....	30
8.3.3. Protokolli .....	31
8.3.4. Magazina .....	31
8.3.5. Prokurime .....	31
SFIDA NË TË ARDHMEN .....	33
PROGRAMI ME KOMUNITETET SHQIPTARE .....	33
OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN NËPËRMJET PROGRAMIT .....	33
TARGET GRUPET .....	33
IMPAKTI .....	34
PRITSHMËRITË .....	34
METODOLOGJIA .....	34
PROGRAMI VJETOR PËR KOMUNITETET SHQIPTARE .....	36
AKTIVITETE TË BASHKËRENDUARA ME MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME .....	37
PËRMBYLLJE .....	38



## HYRJE

Agjencia Kombëtare e Diasporës është ndër institucionet kryesore shtetërore përgjegjëse për zbatimin e politikës së qeverisë shqiptare në marrëdhëniet e diasporës shqiptare me vendin e origjinës. Ajo ka për mision nxitjen dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me komunitetet shqiptare në diasporë, me qëllim zbatimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse në zhvillimin ekonomik, politik, social dhe kulturor të Shqipërisë.

Raporti Vjetor 2023 është një përmbledhje e funksioneve dhe aktiviteteve të realizuara nga Agjencia Kombëtare e Diasporës, kundrejt objektivave kryesorë vjetorë dhe atyre strategjikë. Agjencia Kombëtare e Diasporës gjatë vitit 2023 ka vepruar në përputhje me drejtimin strategjik dhe në një frymë me politikën qeveritare në fushën e diasporës. Raporti shërben për të informuar institucionet përgjegjëse dhe publikun rreth veprimtarisë të Agjencisë gjatë vitit 2023. Disa prej çështjeve kryesore të trajtuara në raport janë: statusi ligjor i Agjencisë Kombëtare të Diasporës; struktura e institucionit, veprimtaria e institucionit gjatë vitit 2023, aktivitetet institucionale, aktet ligjore bazë për veprimtarinë e AKD si dhe analiza financiare për vitin 2023.

## OBJEKTIVAT E ARRITURA GJATË VITIT 2023

- Konsolidimi i bashkëpunimit institucional me diasporën, bashkëveprimi i ngushtë me organizatat vepruese në diasporë;
- Ruajtja e identitetit gjuhësor e kulturor si dhe fuqizimi i lidhjeve me komunitetet shqiptare në botë;
- Nxitja e bashkëpunimit ekonomik nëpërmjet investimeve nga diaspora;
- Ndërgjegjësimi dhe lehtësimi i përfshirjes së diasporës në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore të vendit;
- Pasurimi i bazës së të dhënave të diasporës shqiptare;
- Promovimi dhe avancimi i të drejtave politike dhe sociale të diasporës;
- Integrimi i pjesëtarëve të diasporës në shtetet ku jetojnë.





## **1. AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS**

Agjencia Kombëtare e Diasporës është person juridik publik, me statusin e "Agjencisë autonome", me seli në Tiranë. Agjencia funksionon në bazë të Ligjit Nr. 115/2017 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës" i ndryshuar.

### **1.1.ORGANET DREJTUESE**

Në përputhje me pikën 3 të nenit 5 të Ligjit Nr. 115/2017 "Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare për Diasporën", i ndryshuar organet drejtuese të Agjencisë janë:

- Këshilli Drejtues
- Drejtori Ekzekutiv

#### **1.1.1. KËSHILLI DREJTUES**

Këshilli Drejtues është organi vendimmarrës për çështjet administrative dhe financiare të Agjencisë. Mënyra e organizimit dhe funksionimit, si dhe kompetencat e Këshillit Drejtues rregullohen përmes Ligjit Nr. 115/2017 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës" si dhe Vendimit Nr. 114/2018 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave për emërimin, shkarkimin dhe shpërblimin e kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës".

Këshilli Drejtues i Agjencisë Kombëtare të Diasporës përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, të cilët zgjidhen nga titullarët e Institucioneve të Administratës Publike të parashikuara në nenin 7 të Ligjit Nr.115/2017, i ndryshuar.

#### **1.1.2. DREJTORI EKZEKUTIV**

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kombëtare të Diasporës është autoriteti më i lartë ekzekutiv i saj. Ai është përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e Agjencisë. Drejtori Ekzekutiv përfaqëson Agjencinë Kombëtare të Diasporës në marrëdhënie me të tretët.

Gjatë vitit 2023, kjo detyrë ushtrohet nga Znj.Sonila Hysi, e cila posedon statusin administrativ, Drejtues i Trupës së Nivelit të lartë Drejtues (TND).



## AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

Drejtori Ekzekutiv raporton periodikisht në Këshillin Drejtues për veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

### 1.2. STRUKTURA ADMINISTRATIVE

Struktura administrative e Agjencisë Kombëtare të Diasporës është miratuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr.111, Datë 10.09.2020 “Për miratimin e Strukturës së Organikës së Agjencisë Kombëtare të Diasporës” dhe përbëhet nga: Drejtoria e Diasporës (Sektori i Diasporës dhe Sektori i Kulturës, Identitetit dhe Komunikimit), Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse si dhe Sektori i Projekteve.

Bazuar në nenin 10, shkronja b), të ligjit 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, një nga burimet financiare për realizimin e misionit të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, janë të ardhurat nga projekte, donacione dhe burime të tjera të ligjshme.

#### 1.2.1. Drejtoria e Diasporës

Drejtorja e Diasporës është përgjegjëse:

- Për koordinimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit të saj;
- Për planifikimin, organizimin dhe zbatimin e detyrimeve të lidhura me qëllimet dhe aktivitetin e Agjencisë.

#### 1.2.2. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse është përgjegjëse:

- Për administrimin e buxhetit të miratuar dhe veprimtarinë financiare të Agjencisë;
- Për përgatitjen e projekt-buxhetit dhe për administrimin e çdo çështjeje që lidhet me hartimin e planit financiar buxhetor afatmesëm e vjetor me qëllim arritjen e objektivave të Agjencisë Kombëtare të Diasporës.


#### 1.2.3. Njësia e Menaxhimit të Projekteve

Njësia e Menaxhimit të Projekteve është përgjegjëse:



- Për planifikimin, drejtimin dhe zbatimin e projekteve në përputhje me misionin e institucionit dhe në nxitje të sipërmarrjes së Diasporës për zhvillimin social-ekonomik dhe kulturor.
- Koordinon me donatorët e projekteve në realizimin e objektivave dhe veprimtarisë të Agjencisë Kombëtare të Diasporës për Zhvillimin e Diasporës:

### STRUKURA E AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS







## 2. USHTRIMI I DETYRAVE FUNKSIONALE

### 2.1.Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021-2025

Agjencia Kombëtare e Diasporës, bazuar në nenin 6 të Ligjit Nr. 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, i ndryshuar, përgatit dhe koordinon punën për hartimin dhe rishikimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën dhe ndjek zbatimin e saj (Strategjia përbëhet nga 72 masa në total dhe 68 indikatorë).

“Strategjia Kombëtare e Diasporës Shqiptare 2021 – 2025” përcakton parimet e politikës shtetërore të Republikës së Shqipërisë për mbështetjen e komuniteteve shqiptare të cilët jetojnë në vendet pritëse në mënyrë të ligjshme. Vizioni i saj ka për synim rivlerësimin e angazhimit të diasporës duke u bazuar në strukturën e marrëdhënieve aktuale të shtetit shqiptar me diasporën.

#### Shtyllat kryesore të Strategjisë

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 është e mbështetur në pesë qëllime kryesore strategjike, me anë të të cilave synohet arritja e objektivave të sipërpërmendura:

1. Qeverisja dhe menaxhimi i njohurive
2. Avancimi i programit të të drejtave politike dhe sociale të diasporës
3. Programi për kapitalin e diasporës dhe lidhjet e tyre në ruajtjen e kulturës kombëtare
4. Përfshirja e diasporës në programin e zhvillimit ekonomik-social të vendit
5. Monitorimi dhe Vlerësimi.

Bazuar në Urdhërin e Kryeministrit Nr. 30, datë 17.2. 2021 “Për përcaktimin e grupit të koordinatorëve për zbatimin e planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2021-2025”, koordinatorët e referuar nga institucionet përgjegjëse raportojnë periodikisht dhe mbajnë një raport të ngushtë komunikimi dhe bashkëveprimi me Agjencinë.



Institucione përgjegjëse për zbatimin e masave janë si më poshtë:

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (kryesuese),  
Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit; Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, INSTAT-i, Akademia e Shkencave, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

Masat e ndjekura gjatë vitit 2023 kanë qasje fleksibël për t'u lidhur dhe angazhuar me diasporën në zhvillimin e vendlindjes duke përdorur një qasje fleksibël zbatimi dhe partneriteti, duke iu referuar gjithashtu angazhimit të përgjithshëm politik të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Për vitin 2023 shkalla e realizimit është 67%.

## 2.2. Këshilli Koordinues i Diasporës

Këshilli Koordinues i Diasporës është organi përfaqësues i marrëdhënieve të Diasporës me institucionet shtetërore shqiptare. Në mbledhjet e tij të rregullta marrin pjesë përfaqësuesit më të lartë të institucioneve shtetërore. Ai është ngritur dhe kryen veprimtarinë e tij mbi bazën e Ligjit Nr. 16/2018 “Për Diasporën” i ndryshuar. Në përputhje me këtë ligj, Agjencia Kombëtare e Diasporës kryen funksionet e sekretariatit teknik të Këshillit Koordinues të Diasporës.

Agjencia koordinon mbledhjet dhe takimet me anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës.

### **Dita Kombëtare e Diasporës-18 Dhjetor /Mbledhja e Këshillit Koordinues të Diasporës.**

Data 18 dhjetor “Dita Kombëtare e Diasporës” shënon një ditë të rëndësishme në fuqizimin e ndjenjës së identitetit dhe vlerave kombëtare të shqiptarëve në diasporë.

Në këtë ditë u zhvillua Mbledhja e Këshillit Koordinues të Diasporës.

Risi këtë vit, ishte prezantimi i 15 anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës gjatë mandatit të dytë të funksionimit të tij.

Veçantia e këtij organi, si i pari në historinë e shtetit shqiptar për të përfaqësuar interesat e shqiptarëve të larguar nga vendlindja, është përkushtimi dhe roli proaktiv i anëtarëve të



## AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

tij në përmbushjen e misionit madhor në forcimin e urave lidhëse me vendin amë duke kontribuar në konsolidimin e një diaspore të vetëdijshme për misionin e saj atdhetar, në ruajtjen, kultivimin dhe përhapjen e gjuhës, kulturës dhe traditave më të mira shqiptare. KKD vijon të mbështesë dhe orientojë potencialet intelektuale të diasporës në shërbim të zhvillimit shoqëror, politik dhe ekonomik të kombit, duke përfaqësuar zërin e komuniteteve shqiptare në shtetet pritëse.

Objektivi kryesor i Mbledhjes së Këshillit Koordinues të Diasporës ishte forcimi i urave lidhëse ndërmjet diasporës përmes përfaqësuesve të saj dhe institucioneve shqiptare, duke krijuar një kuadër të plotë institucional në këtë drejtim, duke zhvilluar një vizion bashkëpunues, përmes dialogut kuptimplotë dhe të strukturuar si dhe kultivimi i partneriteteve të cilat shërbejnë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Mbledhja konsistoi në një seancë publike me prezencën e personaliteteve dhe përfaqësuesve të institucioneve shtetërore dhe vijoi me dy seanca vetëm me praninë e anëtarëve të KKD-së dhe Zv. Ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme (në cilësinë e ministrit përgjegjës për diasporën).

Forma e zhvillimit të aktivitetit ishte format hibrid me gërshetim prezencë fizike dhe pjesëmarrje on-line.

Në seancën e parë publike morën pjesë sipas legjislacionit z.Igli Hasani, Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme –Ministër përgjegjës për diasporën, Znj.Artemis Malo Zv. Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Z.Besart Kadia, Zv. Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Znj.Romina Kuko Zv. Ministër përgjegjës për Punët e Brendshme, z.Lavdrim Krashi, Kryetar i NënKomisionit Parlamentar për Migracionin dhe Diasporën, Znj.Elva Margariti Ministër përgjegjës për Kulturën, Z.Illirjan Celibashi Kryekomisioner /KQZ, përfaqësues nga RTSH, Agjencia Kombëtare e Diasporës, si dhe përfaqësues të Qendrave Kulturore të Diasporës.

Në këtë seancë u dhanë mesazhet politike dhe fjalët përshëndetëse nga përfaqësues të politikës dhe të diasporës si edhe nga personalitete shqiptare në fusha të ndryshme.

Në seancën dytë u diskutuan prezantimi i institucioneve përgjegjëse të diasporës dhe çështje të veprimtarisë vjetore të tyre si vendimarrjes së Këshillit, ndarja e anëtarëve në grupe pune, diskutime rreth aktiviteteve të realizuara gjatë vitit 2023 e të koordinuara nga anëtarët në vendet pritëse si dhe propozime për vitin 2024, duke veçuar organizimin e Kuvendit të Diasporës. Gjithashtu u shpалosen iniciativa të anëtarëve të Këshillit.





Në seancën e tretë u zgjodhën organet drejtuese me votim. Një pikë e veçantë e rendit të ditës ishte edhe amendimi në Rregulloren e funksionimit të Këshillit Koordinues të Diasporës.

### **2.3.SAMITI I TRETË I DIASPORËS**

Në kuadër të Samitit të tretë të Diasporës zhvilluar në datë 22 dhe 23 nëntor 2023, në Tiranë, nën drejtimin dhe koordinimin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Agjencia Kombëtare e Diasporës ishte bashkëorganizatore e këtij eventit madhor.

Aktiviteti i shtrirë në dy ditë Dita e Arbëreshëve dhe Samiti III i Diasporës, shërbeu si një hapësirë diskutimi mbi format e mundshme të bashkëpunimit mes institucioneve të shtetit shqiptar dhe diasporës, me objektivin kryesor rienergjizimin e bashkëpunimit me diasporën, duke vënë në lëvizje forma konkrete bashkëpunimi në disa fusha.

Samiti u zhvillua në një seancë plenare dhe në disa grupe pune tematike, nën drejtimin e ministrive të linjës.

Në Sesionin Plenar morën pjesë e autoritete të larta shtetërore të Republikës së Shqipërisë dhe nga rajoni: Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Lugina e Preshevës dhe përfaqësues të spikatur nga diaspora.

Programi vijoi me Tryezat sektoriale/ panele tematike, nën drejtimin e Ministrive të linjës:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Turizimit dhe Mjedisit:
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural:
- Ministria e Arsimit dhe Sportit:
- Ministria e Kulturës:
- Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë & Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë



Impakti i Samitit III të Diasporës ishte në tre dimensione:

#### 1.Kulturor

- Ruajtja e gjuhës dhe identitetit kombëtar në komunitetet shqiptare kudo në botë;
- Nxitja e atdhedashurisë;
- Veçoritë dhe karakteristikat e Diasporës shqiptare- Diaspora e hershme tradicionale & Diaspora e re.
- Promovimi i figurave dhe personaliteteve shqiptare që spikatin për histori suksesi në diasporë;
- Mekanizma dhe projekte kulturore, që nxitin bashkëveprimin midis të rinjve shqiptarë në Diasporë dhe atyre europian apo nga Ballkani.
- Nxitja e diasporës shqiptare në zhvillimin e kërkimit shkencor, teknologjisë em inovacionit.

#### 2.Ekonomik

- Përfshirje e diasporës në zhvillimin ekonomik të vendit të origjinës;
- Volumi i tërhequr i investimeve nga diaspora;
- Rritja e numrit të startup-eve nga diaspora shqiptare (ekosistemi i startup-eve)
- Nxitja e investimeve nga diaspora në sektorë prioritarë apo identifikimi i trendeve të reja të investimeve (infrastrukturë turistike; agroturizëm, kulinari, zeytari etj)

#### 3.Social

- Forcimi i urave lidhëse ndërmjet Diasporës dhe vendit amë;
- Eksplorimi i mënyrave të reja për të nxitur zhvillimin e kapitalit njerëzor bashkëpunues.
- Mbështetja e organizatave të diasporës për tu institucionalizuar dhe funksionalizuar nëpërmjet programeve dhe partneriteteve në një kornizë koherente dhe të qëndrueshme.
- Informimi mbi zhvillimet në kuadër të implementimit të votës së diasporës, nëpërmjet KQZ.



### 3. AKTIVITETET E AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka hartuar programin vjetor duke u bazuar në nevojat dhe kërkesat e drejtpërdrejta të pjesëtarëve të diasporës shqiptare si dhe kërkesave që rrjedhin nga zbatimi i “Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2021-2025”.

#### TARGET GRUPET

Target grupet fokus i planit të veprimtarive të Agjencisë për vitin 2023:

1. Komunitetet e hershme dhe të reja shqiptare në diasporë;
2. Komuniteti i grave shqiptare në biznes;
3. Shoqatat e kërkuesve shkencorë dhe akademike (brain gain vs brain drain);
4. Rrjetëzimi i profesionistëve në diasporë nëpërmjet shoqatave të mjekëve, juristëve, artistëve, biznesmenëve, etj;
5. Shoqatat, organizatat, grupet lokale dhe rrjetet e krijuara nga diaspora shqiptare;
6. Forumet e të rinjve të lindur/rritur në diasporë.

#### 3.1. AKTIVITETE ME KOMUNITETET SHQIPTARE

##### 3.1.1. Aktivitet me rastin e kremtimit të Pavarësisë së Kosovës organizuar nga komuniteti shqiptar në Zvicër, në datë 18 shkurt 2023

Me rastin e kremtimit të Pavarësisë së Kosovës, Agjencia Kombëtare e Diasporës ishte pjesë e aktivitetit kulturor organizuar nga komuniteti shqiptar në Zvicër, në datë 18 shkurt 2023.

Në këtë kuadër u bashkërendua me Shoqatën shqiptare “Bashkimi” Uster, Zyrih.

Prania e Agjencisë në aktivitet u realizua duke patur në vëmendje prezencën e shqiptarëve në shtetin pritës të cilët përbëjnë aktualisht komunitetin e katërt më të madh, të huaj në Zvicër.

Festimet në kuadër të 15 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, kremtuan kurorëzimin e sakrificave madhore të një populli që lirinë, kombin, flamurin e ka të



## AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

trashëguar historikisht në ADN e tij. Atmosfera e krijuar evidentoi dhe një herë të vërtetën se shqiptarët pavarësisht ku jetojnë ruajnë identitetin kombëtar dhe gjuhën amë, duke bashkuar diasporën nga të gjitha trevat shqipfolëse.

Identeti i një kombi fillon nga gjuha, dhe pikërisht përmes këtij aktiviteti u përcoll forcimi i ndjenjës së identitetit kombëtar, në ruajtjen dhe kultivimin e gjuhës shqipe dhe krijimin e një lidhje të qëndrueshme midis diasporës shqiptare në Zvicër dhe Republikës së Shqipërisë dhe Kosovës.

U realizuan takime me aktivistë kryesisht të rinj dhe figura të spikatura nga diaspora shqiptare.

U nënshkrua Marrëveshje bashkëpunimi midis Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Shoqatës Kulturore Shqiptare “Bashkimi” duke shënuar fillimin e bashkëpunimit institucional dhe duke çelur shtigje të reja bashkërendimi për çështje me interes të përbashkët në fushën e diasporës.

Gjithashtu me misionin parësor ruajtjen e trashëgimisë kulturore të trevave shqiptare, u realizua ekspozitë me veshje tradicionale artizanale shqiptare duke ruajtur dhe tejçuar brez pas brezi vlerat e trashëgimisë së pasur kulturore të vendit tonë.

### **3.1.2. Aktivitet me rastin e kremtimit të Pavarësisë së Kosovës organizuar nga komuniteti shqiptar në Mbretërinë e Bashkuar në datë 19 shkurt 2023, në Londër.**

Me rastin e kremtimit të Pavarësisë së Kosovës, Agjencia Kombëtare e Diasporës ishte pjesë e aktivitetit kulturor organizuar nga shoqata “Ardhmëria” në Londër.

Shoqatat, organizatat, grupet lokale dhe rrjetet e krijuara nga diaspora shqiptare në të gjithë botën, luajnë një rol thelbësor në ruajtjen e gjuhës, traditave dhe identitetit kombëtar, për këtë qëllim u koordinua me Shoqatën Ardhmëria.

Nëpërmjet pranisë së Agjencisë në aktivitet u mundësua forcimi i urave ekzistuese dhe krijimin e urave të reja të komunikimit dhe ndërveprimit reciprok, ndërmjet dy vendeve tona ku ndërthuren vlerat më të mira kombëtare me një gjuhë dhe një kulturë të përbashkët dhe u inkurajua shkëmbimi i eksperiencave dhe programeve në fushën e diasporës si dhe bashkëpunim të drejtpërdrejtë midis institucioneve përgjegjëse për diasporën të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.



### 3.1.3. Aktivitet organizuar nga komuniteti arbëresh në rajonin Kalabrisë.

Agjencia Kombëtare e Diasporës mori pjesë në Shfaqjen e XXVIII kulturore folklorike për vlerësimin e pakicave etnike në maj 2023 në komunën e Frasnitës, në Kalabri të Italisë.

Aktiviteti u organizua nga Shoqata Kulturore “Progetto Caraffa” me mbështetjen e institutit shtetëror “G.Sabatini” dhe Institutit Polo Arbëresh të Lungro-s, nën kujdesin e Komunës Arbëreshe Frasnita.

“Projekti Caraffa” është një ndër veprimtaritë, e cila prej 30 vitesh ka në fokus krijimin e një bashkëpunimi ndërmjet shkollave arbëreshe dhe mësimin e gjuhës dhe kulturës arbëreshe tek brezat e rinj. Aktualisht projekti ka bërë rreth vetes 30 komuna arbëreshe. Në këtë kuadër u mbajt Konferencë kushtuar albanologut, demologut dhe intelektualit progresist të njohur arbëresh Vincenzo Dorsa. Në 200 vjetorin e studiuesit, shkrimtarit dhe përkthyesit arbëresh Vincenzo Dorsa u bënë bashkë komunat arbëreshe në ruajtjen e trashëgimisë të gjuhës dhe kulturës arbëreshe tek brezat e rinj. Kryefjala e kësaj konference ishte ruajtja e identitetit kulturor dhe gjuhësor të komunave arbëreshe në Itali.

Gjatë konferencës u vu theksi tek humbja e identitetit gjuhësor dhe kulturor tek brezat e rinj arbëresh. Një hapsirë e gjerë u kushtua problemeve të zbatimit të ligjit nr.482, datë 15 dhjetor 1999 “Mbi minorancat gjuhësore historike” në Itali dhe nevojën që gjuha arbëreshe të përfshihet si lëndë e detyrueshme dhe jo vetëm me zgjedhje, sikurse është tashmë e aplikuar në shkolla.

U zhvilluan takime me figuratë spikatura dhe përfaqësue të institucioneve si Prof. Cettina Mazzei, Kryetarin e Komunës Frasnitë, Z. Angelo Catapano, Drejtuesin e Instituto omicomprendivo Polo Arbëresh të Lungro-s, Z.Gianfranco Maletta, etj, mësues arbëresh të cilët theksuan të njëjtat çështje për zbatimin e ligjit nr.482, 15 dhjetor 1999 “Mbi minorancat gjuhësore e historike” në Itali.

U realizua manifestim folklorik me nxënësit e shkollave arbëreshe të Kalabrisë përgjatë rrugëve të Frasnitës. Në këtë manifestim morën pjesë kryetarët e Komunave Arbëreshe të cilat u bënë pjesë e këtij projekti. Manifestimi në rrugët e komunës prezantoi kostumet, këngët dhe vallet tradicionale të ruajtura në shekuj nga komuniteti arbëresh në Itali.





## AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

Aktivitetit përfundoi me konkursin ndërmjet shkollave arbëreshe pjesëmarrëse, me interpretimin e grupeve folklorike ku u ndanë dhe çmime për nxënësit dhe interpretuesit më të spikatur.

### **3.1.4. Aktivitetit kulturor organizuar nga shoqata “Ardhmëria” me rastin e Festës së Fëmijëve, në datë 11 qershor 2023, në Londër.**

Agjencia Kombëtare e Diasporës iu bashkëlidh aktivitetit kulturor organizuar nga shoqata “Ardhmëria” me rastin e Festës së Fëmijëve, në datë 11 qershor 2023, në Londër.

Ky aktivitet afroi fëmijët shqiptarë në diasporë me njëri-tjetrin, si dhe shërbeu si burim për nxjerrjen e talenteve. Shkolla shqipe “Ardhmëria” ka qenë dhe vazhdon të jenë një shembull i shkëlqyer i nivelit të lartë në mësimdhënies nga një trup pedagogjik tejet cilësor. Kjo shkollë ka hapur dyert për çdo vizitë që u është bërë nga përfaqësues qeveritarë të shtetit amë, përfaqësues të shtetit anglez apo nga çdo qytetar i thjeshtë, për ta njohur nga afër mënyrën se si është afruar pranë fëmijëve dhe të rinjtë nëpërmjet mësimdhënies.

Bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Shoqatën “Ardhmëria”, Agjencia Kombëtare e Diasporës në cilësinë e organit shtetëror përgjegjës për marrëdhëniet me diasporën dhe në përmbushje të misionit të saj në zhvillimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me diasporën, iu bashkëlidh aktivitetit në fjalë me një ekspozitë etnografike me objekt promovimin e veshjeve tradicionale të vjetra dhe të rindërtuara, të prezantimit të suvenirëve artizanale të punuar nga artizanë shqiptarë si dhe performancën e një këngëtar (artist) gjatë aktivitetit festiv në mënyrë që eventit përveç atmosferës artistike iu shtuan dhe ngjyrat kombëtare dhe patriotike.

### **3.1.5. Festivali Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës datë 24-30 qershor 2023.**

Agjencia Kombëtare e Diasporës u bë pjesë e eventit të rëndësishëm kulturor të vendit, Festivalit Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës në kuadër të pjesëmarrjes së shoqatave dhe grupeve folklorike nga diaspora, në datat 24-30 qershor 2023.

Në të morën pjesë të gjitha grupet folklorike shqiptare dhe grupe nga shqiptarët e diasporës së Amerikës, Mbretërisë së Bashkuar, Zvicrës, Greqisë, Arbëreshët e Italisë si dhe nga trevat shqipfolëse si Tuz, Mali i Zi etj, ku këngëtarë, rapsodë, valltarë,





instrumentistë dhe formacione muzikore, trashëgimtarë pasionantë të këngëve e valleve tradicionale përcollën me mjeshtëri vlera të jashtëzakonshme dhe unike të trashëgimisë folklorike, pjesë e identitetit tonë kombëtar.

Karakteristikë dalluese e këtij aktiviteti të rëndësishëm kulturor ishte pjesëmarrja e brezit të ri të lindur jashtë vendit të cilët ruajnë me përkushtim lidhjet me vendin amë dhe pasionin për njohjen e rrënjëve të tyre përmes kultivimit të gjuhës, kulturës, traditave kombëtare, etj.

*Agjencia Kombëtare e Diasporës në kuadër të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve të saj institucionale organizoi takime me grupet nga diaspora: Grupi i valleve Gjergj Kastrioti Michigan, SHBA, Grupi folklorik Rozafati, NY SHBA, Shoqata Kulturore “Bashkimi” Uster, Zyrih, Zvicër, Grupi polifonik “Lot Kurbeti” Greqi, Ansambli “Lura” Londër, Mbretëri e Bashkuar, Arbëreshët e Italisë.*

Këto takime u realizuan me objektivin parësor ruajtjen e identitetit kulturor e gjuhësor në diasporë.

Agjencia Kombëtare e Diasporës në koordinim me Bashkinë Gjirokastrë realizuan një takim të përbashkët me grupet folklorike nga diaspora në ambientet e Bashkisë Gjirokastrë.

Agjencia Kombëtare e Diasporës zhvilloi një ekspozitë/minimuze lëvizës e cila kishte për qëllim krijimin, ruajtjen, dhe ekspozimin e veshjeve dhe materialeve të ndryshme etnografike, riprodhimin e veshjeve tradicionale duke ruajtur të gjitha praktikat artizanale të punimit të tyre, përfshirja e materialeve etnografike në veprimtaritë folklorike të të gjitha niveleve dhe grupmoshave të ndryshme, ruajtja si dhe zgjerimi i njohurive në lidhje me gjuhën, zakonet, traditat dhe në tërësi të trashëgimisë kulturore.

Gjatë ditëve të zhvillimit të këtij eventi nëpërmjet ekspozitës u krijua një atmosferë patriotike dhe festive ku përveç minizuzeut/ekspozitës, sollli workshope me muzikë shqiptare si dhe kënde artizanale përfshirë materiale, sete qëndisjeje dhe plot sketche që turistët, fëmijët dhe publiku i gjerë pati mundësinë të pikturojnë, qëndisin dhe të argëtohen me detajet e mrekullueshme të traditës shqiptare.

### **3.1.6. Aktivitet me komunitetin Arbëresh në Piana degli Albanesi, rajoni i Siçilsë në datë 29-30 gusht 2023**



## AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

Me rastin e kremtimit të themelimit të Hora e Arbëreshëve në Siçili, Itali 29-30 gusht 2023, Agjencia Kombëtare e Diasporës u bashkëlidh në këtë aktivitet me qëllim forcimin e ndjenjës së identitetit kombëtar, në ruajtjen e gjuhës shqipe dhe kulturës e traditave kombëtare si dhe vazhdimësinë e krijimit të një lidhje të qëndrueshme midis komunitetit më të hershëm Arbëresh dhe institucioneve të Republikës së Shqipërisë.

Përfaqësuesit e Agjencisë Kombëtare të Diasporës realizuan takime me përfaqësues të komuniteteve arbëresh dhe vizitë në Bibliotekën “Hora e Arbëreshëve” ku ruhen vepra të letërsisë arbëreshe. Në këto takime u diskutua për mekanizmat e forcimit të ruajtjes së kulturës dhe gjuhës shqipe në veçanti për brezin e ri.

Gjatë aktivitetit Agjencia mundësoi një aktivitet kulturor me këngë të motiveve arbëreshe duke gërshetuar gjuhën shqipe letrare të ditëve të sotme dhe gjuhën shqiptare arbëreshe nëpërmjet artit të bukur të fjalës dhe muzikës për prezantimin e kulturës shqiptare dhe nëpërmjet një interpretimi artistik, duke i ardhur në ndihmë qëllimit të saj primar ruajtjen e traditave, kulturës shqiptare si dhe të gjuhës shqipe.

### **3.1.7. Aktivitet me komunitetin Arbëresh në Piana degli Albanesi, rajoni i Siçilsë në date 22-23 Shtator 2023.**

Agjencia Kombëtare e Diasporës me qëllim forcimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me diasporën, prezantimin e kulturës shqiptare dhe e vlerave të saj, iu bashkëlidh programit të aktiviteteve të komunitetit Arbëresh në Piana degli Albanesi, Sicili në datat 22-23 Shtator 2023.

Në përmbushje të detyrave institucionale, me misionin primar ruajtjen e trashëgimisë kulturore u realizua një shfaqje teatrale e gjinisë dramë me titull “Gjaku i Dëshmorëve të Kombit” në komunën e Horës së Arbëreshëve, në Sicili.

Ky aktivitet u mundësua nga Agjencia Kombëtare e Diasporës bazuar në Marrëveshjen e bashkëpunimit midis Shoqatës Kulturore “Bijtë e Dritës” në përmbushje të detyrave institucionale ku vend të mëvetësishëm zë bashkëpunimi me organizatat brenda dhe jashtë vendit për përmirësimin e pozitës së diasporës në botë dhe ndihmesën në ruajtjen dhe e gjuhës dhe kulturës shqiptare

Qyteti dhe banorët e tij, në çdo qelizë të jetës zbulojnë një pasuri, ndoshta atë më të madhen identitetin etniko-gjuhësor, që ruhet nga shekulli XV e që përbën vlerën me të rëndësishme të shqiptarëve të Hora e Arbëreshëve. Kjo është edhe një ndër arsytet që



Agjencia Kombëtare e Diasporës ju ka ardhur dhe do i vijë në ndihmë ruajtjes së vlerave unike që mbart ky komunitet i hershëm ndër vite.

Nën kujdesin e Z. Rosario Petta/ Kryetar i Bashkisë, u realizua një takim me kryetarët e komunave të tjera arbëreshe përreth, Santa Cristina Gela, Mezzojuso, Contessa Entellina, Palazzo Adrianosi si dhe me kardinalin e kishës së këtij komuniteti, të ftuar posaçërisht për shfaqjen e pjesës teatrale, në datë 23.09.2023. Në këtë takim u vlerësua puna e bërë nga Agjencia Kombëtare e Diasporës deri tani për komunitetin Arbëresh dhe u shpalosën projektet e ardhshme.

### **3.1.8. Tryezë e Rrumbullakët “Emigrimi në Mbretërinë e Bashkuar, një guidë drejt rrugëve ligjore” në datat 10 dhe 13 nëntor 2023 në Bashkinë Kukës dhe Universitetin Qiriazhi në Kamëz.**

Agjencia Kombëtare e Diasporës së bashku me Bashkinë Kukës, ekspertët Av. Arta Heath dhe Prof.Stuart Franklin nga Mbretëria e Bashkuar, organizuan Tryezën e Rrumbullakët “Emigrimi në Mbretërinë e Bashkuar, një guidë drejt rrugëve ligjore” në datat 10 dhe 13 nëntor 2023 në Bashkinë Kukës dhe Universitetin Qiriazhi në Kamëz.

Agjencia Kombëtare e Diasporës në të dy aktivitetet e zhvilluara nënvizoi rolin e diasporës si një aset dhe vijimin e forcimit të bashkëpunimit institucional me komunitetin shqiptar në Mbretërinë e Bashkuar.

Aktiviteti bëri bashkë përfaqësues të institucioneve shtetërore, njësisive të vetëqeverisjes vendore, strukturave për diasporën dhe migracionin, shoqërisë civile, Avokatit të Popullit Zyra Rajonale Kukës, profesorë e studentë të Universitetit "Qirjazhi", si dhe partnerë vendas dhe të huaj me qëllim informimin mbi rrugët e ligjshme të lëvizjes drejt Mbretërisë së Bashkuar fokusuar kryesisht në Bashkitë me tendencë të lartë të migrimit drejt vendit pritës.

### **3.1.9. Aktivitet me komunitetin shqiptar në Zvicër.**

Agjencia Kombëtare e Diasporës iu bashkëlidh aktivitetit me rastin e 30 vjetorit të themelimit të Shoqatës “Bashkimi” në datë 28 tetor 2023, në Uster, Zyrih Zvicër.

Aktiviteti bëri bashkë personalitete të spikatura, përfaqësues të institucioneve dhe diplomacisë si: Kryetarja e Qytezës së Usterit znj.Barbara Talman, Ambasadori i



## AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

Republikës së Shqipërisë në Zvicër z.Mustafa Nano, Ambasadori i Republikës së Maqedonisë z.Rexhep Demiri, Konsullja e Republikës së Kosovës në Zvicër znj.Arjeta Gallapeni, përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Diasporës të cilët vunë në pah vlerat e jashtëzakonshme që mbart komuniteti shqiptar në Zvicër, shkallën e lartë të integritimit në jetën dhe shoqërinë zviceriane por njëkohësisht rolin e rëndësishëm në ruajtjen e lidhjeve të forta me vendin amë.

Agjencisë Kombëtare të Diasporës iu akordua Çertifikatë Mirënjohje, për kontributin e dhënë në forcimin dhe konsolidimin e marrëdhënieve institucionale me diasporën si dhe vëmendjen ndaj këtij komuniteti.

Agjencia iu bashkëlidh aktivitetit në fjalë bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit lidhur me Shoqatën kulturore Bashkimi, me performancën e një artisti i cili performoi në zhanrin e muzikës me ngjyra patriotike.

### **3.1.10. Konferencë organizuar nga OSCE Prezenca në Shqipëri me objekt projekti “Mbështetje për reformën zgjedhore në Shqipëri” në datë 17 Tetor 2023, në Tiranë.**

Agjencia Kombëtare e Diasporës ishte pjesë e Konferencës organizuar nga Prezenca në Shqipëri e OSCE me objekt projektin “Mbështetje për reformën zgjedhore në Shqipëri” në datë 17 Tetor 2023, në Tiranë.

Konferenca mbledhi së bashku aktorë vendas dhe të huaj, partnerë, politologë dhe përfaqësues të institucioneve ligjzbatuese si Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), Agjencia Kombëtare e Diasporës, Struktura e gjendjes civile /Ministria e Brendshme etj. Përmes këtij Projekti Prezenca e OSCE në Shqipëri do të mbështesë autoritetet shtetërore me ekspertizë dhe ndihmë logjistike për realizimin e votimit nga jashtë vendit në zgjedhjet për Kuvendin. Projekti do të kontribuojë gjithashtu në përmirësimin dhe depolitizimin e administrimit të zgjedhjeve duke ofruar trajnime sistematike dhe profesionale për administratën zgjedhore, fushata informimi dhe edukimi për zgjedhësit, duke përfshirë zgjerimin e kapaciteteve logjistike të infrastrukturës teknologjike për zbatimin e votimit nga jashtë vendit, si dhe proceseve për trajnimin/edukimin zgjedhor. Kohëzgjatja e projektit do të jetë deri në muajin nëntor 2026.





### 3.1.11. Java Ndërkombëtare e Sipërmarrjes (GEW)

Agjencia Kombëtare e Diasporës ishte pjesë e panelit “Impakti i Diasporës në zhvillimin e sipërmarrjes” në kuadër të Javës Ndërkombëtare të Sipërmarrjes (GEW), në datë 15 nëntor 2023, në Tiranë e cila u mbajt me synim promovimin e inovacionit dhe kreativitetit të sipërmarrësve.

Gjatë takimit nga Agjencia u theksua se ndër prioritetet për marrëdhëniet me diasporën, është nxitja e bashkëpunimit ekonomik midis diasporës dhe vendit amë.

### 3.1.12. Aktivitet me komunitetin shqiptar në Gjermani

Agjencia Kombëtare e Diasporës u bë pjesë e simpoziumit shkencor me temë "Ndërtimi i një platforme për përkrahjen e bashkëpunimit dhe rrjetëzimit të diasporës shkencore shqiptare", organizuar nga Shoqëria e Akademikëve shqiptar “Dija”, në Mynih, në datat 24 dhe 25 nëntor 2023 në kudër të veprimtarive "Takimet e Mynihut".

Krahas Agjencisë Kombëtare të Diasporës të pranishëm ishin dhe përfaqësues nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Republikës së Kosovës, GIZ Albania dhe Germin, ku ishin të pranishëm akademikë nga diaspora, Shqipëria e Kosova, si dhe studentë nga Gjermania.

Në panel u vu theksi rreth rrjetëzimit të diasporës shkencore si dhe objektivave në mbështetje të diasporës shqiptare.

## 4. DATABAZA E STUDENTËVE

“Baza e të Dhënave Shtetërore të Studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë” është produkt i Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 504, datë 24.06.2020, "Krijimi i bazës së të dhënave shtetërore të studentëve që studiojnë jashtë vendit dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë”, është ngritur sistemi i brendshëm i databazës.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 504, datë 24.06.2020, dhënës të informacionit për bazën e të dhënave shtetërore të studentëve, të cilët studiojnë jashtë



## AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, janë Ministria përgjegjëse për Arsimin dhe Ministria përgjegjëse për Punët e Jashtme.

### 5. MEMORANDUME BASHKËPUNIMI

Gjatë vitit 2023 janë lidhur Memorandum bashkëpunimi ndërmjet palëve:

- Memorandum bashkëpunimi lidhur ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Shoqatës shqiptare kulturore “Bashkimi” Uster, Zvicër.
- Memorandum bashkëpunimi lidhur ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Qendrës Kulturore Shqiptare “Maison de l’Albanie”.
- Memorandum bashkëpunimi lidhur ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Shoqatës Kulturore “Bijtë e Dritës”.

### 6. BOTIME

#### 6.1. DIASPORA SHQIPTARE NDËR VITE

Agjencia Kombëtare e Diasporës gjatë vitit 2023 realizoi një botim me titull: “Diaspora Shqiptare ndër Vite”.

Në këtë botim pasqyrohen figura të spikatura në diasporë nga shek. XVI deri në ditët e sotme, të cilët kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në historiografinë shqiptare, në përfaqësimin e shtetit shqiptar dhe mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve në arenën ndërkombëtare, ruajtjen dhe kultivimin e gjuhës shqipe, vendosjen e themeleve të një letërsie kombëtare shqiptare, në shpalljen e pavarësisë, në mbrojtjen e çështjeve të popullit shqiptar në të drejtën për të qenë një shtet i lirë dhe i pavarur, në ngritjen e shkollave të para shqipe, e të tjera kontribute.

Gjithashtu, spikasin figura me kontribut të rëndësishëm gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare.





## **7. PUBLIKIME**

### **7.1.BULETINI I MASAVE TË PLANIT TË VEPRIMITI**

Në vitin 2023, Agjencia Kombëtare e Diasporës ka vijuar të publikojë buletin për zbatimin e masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës. Buletini synon të informojë publikun e gjerë, anëtarët e Komisionit për Politikën e Jashtme pranë Kuvendit, anëtarët e Nënkomisionit për Diasporën dhe Migracionin, anëtarët e Këshillit Shtetëror të Diasporës dhe Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës dhe publikun e gjerë në angazhimin e çdo institucioni përgjegjës në zbatimin e masave të Planit të Veprimit të Strategjisë.

Publikimi i buletineve gjashtë mujorë shërben si një praktikë bazuar në parimin e transparencës dhe nxit llogaridhënien institucionale. Ai bën publike punën e Agjencisë Kombëtare të Diasporës përpara një komuniteti jo prezent në vendlindje, siç është diaspora shqiptare.

### **7.2.NEWSLETTER PËR DIASPORËN**

“Newsletter e Diasporës” është një buletin informativ javor i cili pasqyron aktivitetet e institucioneve të Diasporës. Qëllimi i kësaj nisme është informimi i publikut të gjerë mbi ecurinë e praktikave që kanë lidhje me diasporën shqiptare.





## 8. RAPORTIM DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

### 8.1. ANALIZË FINANCIARE JANAR-DHJETOR 2023

Agjencia Kombëtare e Diasporës, për realizimin e buxhetit të vitit 2023 është mbështetur në nevojat më të domosdoshme institucionale dhe zbatimin korrekt të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 115, datë 18.12.2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2019-2025 dhe Planit të Veprimit.

Ky raport përfshin periudhën Janar – Dhjetor 2023 dhe pasqyron funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës.


Bazuar në shkresën Nr.19180 Prot., datë 15.12.2022, Agjencisë Kombëtare të Diasporës për vitin 2023, i është transferuar fondi buxhetor prej 85,600,000 (tetëdhjetë e pesë milion e gjashtëqind mijë) lekë, i detajuar si më poshtë:

– Shpenzime personeli (paga dhe sigurime shoqërore)	<b>17,900,000 lekë;</b>
– Shpenzime korrente (mallra dhe shërbime, bursa)	<b>59,700,000 lekë;</b>
– Shpenzime kapitale (investime)	<b>8,000,000 lekë.</b>

---

**Gjithsej**

**85,600,000 lekë**






Me hyrjen në fuqi të VKM nr. 325, datë 31.5.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, fondet buxhetore të Agjencisë Kombëtare të Diasporës ndryshuan si më poshtë:

– Shpenzime personeli (paga dhe sigurime)	21,300,000 lekë;
– Shpenzime korrente (mallra dhe shërbime, bursa)	59,700,000 lekë;
– Shpenzime kapitale (investime)	8,000,000 lekë.
– Fond i vecantë	100,000 lekë

---


**Gjithsej**
**89,100,000 lekë**


## 8.2. Realizimi

Agjencia Kombëtare e Diasporës, referuar buxhetit të vitit 2023, ka zbatuar politikën e veta ekonomike, për një menaxhim sa më të mirë dhe me efektivitet të shpenzimeve buxhetore, duke planifikuar shpenzimet e kontraktuara si dhe shpenzimet e tjera, më të domosdoshme, në mbështetje të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Në përfundim të vitit buxhetor Janar-Dhjetor 2023, rezulton se shpenzimet faktike janë realizuar si më poshtë:


**TABELA E BUXHETIT DHE REALIZIMI (PLAN-FAKT)**

Llog.ek	Përshkrimi	Buxheti Plan 2023	Buxheti Fakt 2023	Buxheti i realizuar %
600	Shpenzime për Paga	18,500,000.00	13,255,955.00	72 %
601	Shpenzime për Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	2,800,000.00	2,170,748.00	78 %
602	Shpenzime Korrente	59,700,000.00	52,047,737.00	87 %
231	Shpenzime Kapitale	8,000,000.00	-	0%
606	Fond i vecantë	100,000.00	-	0%



Në tabelën e mëposhtme paraqiten detajimi i shpenzimeve korrente me elementet përbërës të tyre.

### 8.2.1. për Fondin e pagave dhe sigurimeve (llogaria ekonomike 600,601)

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, u realizua në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Gjatë kësaj periudhe numri mesatar i punonjësve u realizua deri në 10 punonjës, nga 16 punonjës të miratuar me Urdhrin Nr.111, Datë 10.09.2020 “Për miratimin e Strukturës së Organikës së Agjencisë Kombëtare të



Diasporës” e përbërë nga Drejtoria e Diasporës (Sektori i Diasporës dhe Sektori i Kulturës, Identitetit dhe Komunikimit), Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse si dhe Sektori i Projekteve.

Fondi i përgjithshëm i pagave dhe i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për këtë periudhë është realizuar për numrin faktik të punonjësve, në vlerën 13,255,955 (trembëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë e pesëmijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë ose 72 % e fondit të planifikuar për vitin 2023 dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 2,170,748 (dy milion e njëqind e shtatëdhjetëmijë e shtatëqind e dyzet e tetë) lekë, ose 78 %, e planifikimit për periudhën respektive. Në shpenzimet më lart janë pasqyruar dhe ndryshimet e pagava sipas VKM nr. 325, datë 31.5.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”

### **8.2.2. Shpenzimet Korrente (mallra dhe shërbime, llogaria ekonomike 602)**

Për periudhën Janar-Dhjetor 2023, fondi i shpenzime korrente është realizuar në vlerën 52,047,737 (pesëdhjetë e dy milion e dyzetë e shtatëmijë e shtatëqind e tridhjetë e shtatë) lekë ose 87 % e fondit të planifikuar.

Në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi, gjatë kësaj periudhe, shpenzimet korrente, kanë konsistuar në:

- Realizimin e shpenzimeve të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrimet për taksa e tatime.
- Realizimin e shpenzimeve të përgjithshme si qira, shpenzime pastrimi, shpenzime interneti, shpenzime telefoni, shpenzime poste.
- Realizimin e shpenzimeve për aktivitetin e realizuar me komunitetin shqiptar në Zvicër.
- Realizimin e shpenzimeve për aktivitete të realizuara me komunitetin shqiptar, Londër.
- Realizimin e shpenzimeve për aktivitete të realizuara me komunitetin arbëresh në Kalabri dhe Siçili.



- Realizimin e shpenzimeve në aktivitetet shoqëruese për Grupet Folklorike nga Diaspora pjesëmarrëse në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës.
- Realizimin e shpenzimeve për aktivitete si Dita e Diasporës dhe Samiti I III-të I Diasporës.
- Realizimin e shpenzimeve për libra, botime për diasporën.

### 8.2.3. Shpenzime kapitale (Ilogaria ekonomike 231)

Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 fondi i shpenzimeve kapitale nuk është realizuar.

### 8.2.4. Fond i veçantë (Ilogaria ekonomike 606)

Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 fondi i vecantë nuk është përdorur nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

## 8.3.DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE (FUNKSIONIMI)

### 8.3.1. Financa

Gjatë kësaj periudhe sektori i financës ka evidentuar me përpikmëri nëpërmjet kontabilizimeve në ditarët përkatës (ditari i magazinës si dhe shpenzimeve të arkës dhe të bankës) të gjitha shpenzimet e kryera në valutë si edhe në lekë.

Në zbatim të ligjit për menaxhimin financiar si dhe udhëzimin në zbatim të tij dhe kontrollin, sektori i financës ka përgatitur të gjitha urdhër-shpenzimet në afatin e caktuar për faturat e paraqitura nga kryerja e prokurimeve publike, pagesat për pagat, honoraret dhe dietat e punonjësve. Janë përgatitur dhe likuiduar 173 urdhër shpenzime. Janë përgatitur brenda afatit të gjitha listë pagesat për pagat si dhe listë pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve. Gjatë kësaj periudhe janë kryer pagesat e pagave të punonjësve nëpërmjet listë pagesave dhe urdhër shpenzimeve të gjeneruara nga sistemi HRMIS.

Bazuar në Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve”, në fund të vitit kryhet inventarizimi i aktiveve.

Janë përgatitur raportimet periodike për Ministrinë e Financave dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, rakordimet me Degën e Thesarit si dhe çdo informacion tjetër me karakter financiar.



### 8.3.2. Burime Njerëzore

Struktura e re e Agjencisë Kombëtare të Diasporës është miratur me Urdhërin Nr.111, datë 10.09.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Diasporës”. Marrëdhëniet e punës për Drejtorin Ekzekutiv dhe nëpunësit e Agjencisë rregullohen sipas dispozitave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për nëpunësin civil.

Burimet njerëzore janë një faktor i rëndësishëm në realizimin e objektivave kryesore institucionale. Në këtë kontekst, Agjencia Kombëtare e Diasporës ka patur si objektiv prioritar jo vetëm ngritjen e kapaciteteve të brendshme por dhe ruajtjen e një strukture organike që do ti mundësonte eficiencë në realizimin e misionit të saj. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore është i orientuar drejt administrimit me korrektësi të dosjeve të personelit, si dhe vlerësimit vjetor të performancës në punë për çdo punonjës, në kohë dhe në përputhje me rregullat administrative përkatëse si dhe identifikimit të nevojave të personelit për përmirësimin e aftësive profesionale të tyre nëpërmjet realizimit të trajnimeve në përshtatje me nevojat profesionale të vendit të punës me qëllim përballimin e sfidave të ndryshme në të ardhmen.

Janë zhvilluar trajnime të ndryshme për nëpunësit e Agjencisë Kombëtare të Diasporës të organizuara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), International Organization for Migration (IOM). Temat e trajnimeve kanë qenë gjithëpërfshirëse, si: "Prezantimi me administratën publike", "Sinjalizimi dhe mekanizmi i funksionimit të tij", "Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm nga Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme dhe raportimi në Ministrinë e financave", "Harmonizimi i Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm (OZHQ/SDG) me politikat kombëtare, në kuadër të planifikimit strategjik", "Sistemet e njohjes së kualifikimeve profesionale", Rregullat e vendosura nga vendet e Bashkimit Evropian për refugjatët dhe azilkërkuesit", "Format e diskriminimit, vështrim krahasues me Direktivat e Barazisë së BE", "Diaspora and Transnational Identities – An Analysis of Legal Frameworks and Policies".

Për të mundësuar realizimin me eficiencë të objektivave dhe misionit të institucionit, në bashkëpunim me DAP-in, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore janë ndjekur procedurat për plotësimin e vendeve vakante.



## AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në përputhje me Ligjin "Për nëpunësin civil", ka realizuar përgatitjen e dosjeve të personelit, si dhe raportime periodike në kuadër të menaxhimit të burimeve njerëzore.

Gjatë këtij viti në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga ligji "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe nëpunësve publik", autoriteti përgjegjës ka ndjekur depozitimin në kohë të formularit të Deklarimit të Interesave Privatë Periodik/Vjetor për subjektet që kanë detyrim deklarimi.

### 8.3.3. Protokollit

Në bazë të ligjit "Për Arkivat", është bërë pritja e shkresave të hyra në institucionin, duke i vendosur kartelën shoqëruese, numrat e protokollit dhe përcjelljen e tyre drejt drejtuesit të Institucionit, i cili bën shpërndarjen e shkresave sipas drejtorive përkatëse. Është kryer procedura ligjore për shkresat dalëse të institucionit tonë, duke verifikuar fillimisht plotësimin e kushteve dhe parametrave që përcakton ligji ynë në pjesën e ndërtimit të shkresave, vendosjen e numrit të protokollit, dërgimit të tyre drejt drejtuesit të Institucionit për firmosje dhe vulosje dhe së fundmi klasifikimin e dokumenteve sipas strukturave organizative të institucionit.

### 8.3.4. Magazina

Në hyrjen dhe shpërndarjen e artikujve nga magazina është ndjekur procedura ligjore duke bërë evidentimet e nevojshme në fletë-hyrjet, fletë-daljet dhe janë bërë pasqyrimet në Librin e Magazinës për sasi të artikujve të dala nga magazina dhe gjendjen e tyre të mbetur në magazinë.

Në fund të vitit është kryer inventarizimi i aktiveve bazuar në Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve".

### 8.3.5. Prokurime

Në zbatim të planit për shpenzime, AKD ka hartuar e zbatuar regjistrin e prokurimeve, i cili gjatë vitit 2023 është realizuar nëpërmjet procedurave të prokurimit me vlera të vogla, si dhe blerjeve nën 100.000 lekë pa tvsh. Bazuar në ligjin Nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik", të ndryshuar, VKM nr.28/2020 "Për miratimin e





Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe udhëzimeve përkatëse në periudhën Janar-Dhjetor janë kryer dhe realizuar me sukses procedurat e prokurimit publik me objekt të ndryshëm prokurimi duke përfshirë “Blerje bileta transportit ajror ndërkombëtar”, “Blerje bojra printeri”, “Blerje materiale kancelarie”, “Blerje produkte promovionale”, “Shërbim mirëmbajtje dhe riparimi të printerave dhe fotokopjeve”, etj.

Janë krijuar në sistemin elektronik të APP-së gjithsej 9 elemente në regjistrin e parashikimeve për vitin 2023. Nga këto janë realizuar 7 elementë nën vlerën 100,000 lekë ndërsa 10 procedura prokurimi mbi vlerën 100,000 lekë.





## SFIDA NË TË ARDHMEN

### PROGRAMI ME KOMUNITETET SHQIPTARE

Nën drejtimin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme si dhe duke patur parasysh implementimin me sukses të aktiviteteve në diasporë në disa shtete ku është vendosur diaspora shqiptare, Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin 2024 ka planifikuar të zgjerojë aktivitetet e saj në një numër më të madh vendesh, kryesisht në vendet që kanë një numër të madh të përqëndruar të diasporës shqiptare. Aktivitetet dhe takimet që synohen të zhillohen janë konceptuar si “Java shqiptare” dhe do të fokusohen në target grupet i identifikuar si dhe në rrjetëzimin e profesionistëve.

### OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN NËPËRMJET PROGRAMIT

1. Konsolidimi i bashkëpunimit institucional me diasporën;
2. Ndërgjegjësimi dhe lehtësimi i përfshirjes së diasporës në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore të vendit;
3. Ruajtja e identitetit dhe fuqizimi i lidhjeve me komunitetet shqiptare në botë;
4. Nxitja e bashkëpunimit ekonomik nëpërmjet investimeve nga diaspora;
5. Ruajtja e gjuhës dhe trashëgimisë kulturore kombëtare si dhe zhvillimi i identitetit të pjesëtarëve të diasporës
6. Pasurimi i bazës së të dhënave të diasporës shqiptare;
7. Promovimi dhe avancimi i të drejtave politike dhe sociale të diasporës;
8. Integrimi i pjesëtarëve të diasporës në shtetet ku jetojnë.

### TARGET GRUPET

1. Komunitetet e hershme dhe të reja shqiptare në Diasporë;
2. Komuniteti i grave shqiptare në biznes;
3. Shoqatat e kërkuesve shkencorë dhe akademike (brain gain dhe brain drain);
4. Rrjetëzimi i profesionistëve në diasporë nëpërmjet shoqatave të mjekëve, juristëve, artistëve, biznesmenëve, etj;
5. Shoqatat, organizatat, grupet lokale dhe rrjetet e krijuara nga Diaspora shqiptare;





6. Forumet e të rinjve të lindur/rritur në diasporë.

### **IMPAKTI**

Nisur nga nevoja e diktuar për angazhimin e diasporës në vendlindje si një mënyrë e re veprimi në zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të Shqipërisë dhe krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për kontributin e tyre, Agjencia Kombëtare e Diasporës ka planifikuar programin vjetor të aktiviteteve i cili do të ndikojë jetën ekonomike, sociale, politike, kulturore të vendit nëpërmjet angazhimit të diasporës.

Programi përcakton një vizion të qartë, prioritetet dhe mënyrën për t'u lidhur dhe angazhuar me diasporën në zhvillimin e vendlindjes duke përdorur një qasje fleksibel zbatimi dhe partneriteti, duke iu referuar gjithashtu angazhimit të përgjithshëm politik të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

### **PRITSHMËRITË**

1. Krijimi dhe forcimi i lidhjeve të forta emocionale, ekonomike, sociale dhe kulturore me komunitetet shqiptare në botë;
2. Rritja e ndërgjegjësimit dhe ngjalljes së ndjenjës së atdhedashurisë për vendin e origjinës;
3. Nisma të inicjuara nga bizneset e diasporës për investime në vendin amë;
4. Pasurimi i bazës së të dhënave me pjesëtarë të rinj nga diaspora e të gjithë target grupeve.
5. Evidentimi i problematikave me të cilat përballet diaspora dhe referimi për trajtim në strukturat përkatëse;
6. Forcimi i besimit ndaj institucioneve të vendlindjes;
7. Integrimi i pjesëtarëve të diasporës në shtetet ku jetojnë.

### **METODOLOGJIA**

Takime me përfaqësues apo personalitete të njohur nga bota akademike dhe politike nëpërmjet takimeve në vendet pritëse që Agjencia do të mundësojë me këto target grupe.

Organizimi i manifestimeve kulturore të natyrës patriotike dhe tradicionale në disa prej shteteve pritëse.



## AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

Krijimi i programeve të shkëmbimit të stafit akademik dhe studentëve nga radhët e diasporës, nisur nga mirëintegrimi i tyre në vendin e pritjes dhe nevoja për përthithjen e potencialit që ato zotërojnë duke i vendosur në shërbim për vendin e origjinës.

Një përqindje e madhe e diasporës sonë është integruar shumë mirë në vendet ku jeton dhe nga kjo diasporë është krijuar një potencial shumë i madh i kapitalit njerëzor dhe ekonomik. Prandaj, integrimi i diasporës në vendet ku jeton dhe vepron është edhe një aspekt i rëndësishëm për marrëdhëniet ndërshtetërore për vendin tonë, duke e përdorur kështu diasporën si partner ndërmjetësues.

Organizimi i vizitave me grupe të rinjsh nga komunitetet shqiptare në diasporë, me qëllim njohjen e tyre me Shqipërinë: gjuhën, traditat, vizitë në objekte kulturore e historike.

Aktivizimi i rolit të institucioneve në promovimin e vlerave që ndikojnë në ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kulturor e gjuhësor;

Mobilizimi i organizatave të biznesit në diasporë, duke i orientuar ato me politikat shtetërore dhe instrumentet, në mënyrë që ato të shndërrohen në ura lidhëse midis interesave të diasporës dhe bizneseve vendase. Këto aktivitete do të përqendrohen në dhënien përparësi të organizatave të biznesit dhe shoqatave brenda vendeve pritëse me bizneset më të mëdha të diasporës.

Fushata informuese për të drejtat; mundësitë dhe obligimet në shtetin e origjinës. Nisur nga fakti se institucionet përgjegjëse për marrëdhëniet me diasporën janë institucione relativisht të reja, është në proces krijimi i një pakete më të plotë institucionale; Njohja e diasporës me politikat e ndërmarra shtetërore për garantimin e së drejtës së votës jashtë vendit me qëllim përfshirjen e jetës së saj në jetën politike të vendit;

Hartimin e bazës së të dhënave përmes mbledhjes sistematike, gjithëpërfshirëse dhe hartëzimin e diasporës si dhe përfshirjen e një game të gjerë të anëtarëve të diasporës në praktika konsultimi nëpërmjet së cilës do të arrihet të kuptohet se çfarë ofron diaspora, çfarë është e gatshme të ofrojë, dhe çfarë pritet në këmbim nga qeveria.

Anëtarët e Diasporës në mbarë botën konsiderohen si forcë lëvizëse dhe potenciali i diasporës mund të dalë në pah vetëm nëse ekzistojnë mekanizma të përshtatshme angazhimi, dhe nëse organizatat dhe organet e tyre përfaqësuese fuqizohen për t'u bërë pjesë e një marrëdhënie të besueshme ndërmjet diasporës, institucioneve dhe publikut të gjerë në vend.



Bashkëveprimi i ngushtë me organizatat dhe shoqatat e diasporës, të cilat përfaqësojnë zërin e anëtarëve të diasporës në vendet pritëse, mund të luajnë një rol të rëndësishëm në proceset strategjike vendimmarrëse në Shqipëri, si dhe mund të nxisin nisma të çmuara për bashkëveprimin shoqëror, ekonomik dhe intelektual ndërmjet diasporës dhe Shqipërisë.

### **PROGRAMI VJETOR PËR KOMUNITETET SHQIPTARE**

Programi vjetor i Aktiviteteve dhe takimeve në diasporë është planifikuar të zhvillohet kryesisht në vendet që kanë një numër të madh të përqëndruar të diasporës shqiptare. Në mbrojtje të traditës dhe identitetit kombëtar komuniteteve shqiptare është planifikuar një program i gjerë aktiviteteve i cili do të jetë i shtrirë në një hapësirë kohore rreth një javë në cdo shtet. Aktivitetet dhe takimet që synohen të zhillohen janë konceptuar si “Java shqiptare” dhe do të fokusohen në target grupet e identifikuar si dhe në rrjetëzimin e profesionistëve dhe konsiston në takime me përfaqësues dhe personalitete të njohur nga bota akademike, politike, e biznesit e me gjerë si dhe vizita në qendrat kulturore dhe shkollat shqipe në komunitetet shqiptare.

Struktura e programeve do të përfshijë aktivitete dhe takime në komunitetet e hershme dhe të reja shqiptare në Diasporë;

Gjithashtu Agjencia Kombëtare e Diasporës ka planifikuar programin vjetor të aktiviteteve i cili do të ndikojë jetën ekonomike, sociale, politike, kulturore të vendit nëpërmjet angazhimit të diasporës, i cili konsiston në;

- Takim mbi Remitancat
- Takim me profesionistë shqiptarë në fushën e mjekësisë
- Takim me gratë që spikasin për histori suksesi
- Takim me rrjetin e avokatëve/juristëve
- Tryezë e rumbullakët me Bizneset shqiptare
- Takime dhe aktivitete në Komunitetin Arbëresh
- Studim dhe simpozium shkencor mbi veshjet/etnografinë
- Takim me forumet e të rinjve të lindur/rritur në diasporë



## AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

### AKTIVITETE TË BASHKËRENDUARA ME MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME

#### **Dita e Diasporës**

##### *Takimi zyrtar i Këshillit të Koordinimit të Diasporës*

Në datën 18 dhjetor 2024 do të mbahet dhe takimi zyrtar i Këshillit Koordinues të Diasporës.

Mbledhja do të zhvillohet në Tiranë në “Ditën Kombëtare të Diasporës”, që shënon një ditë të rëndësishme në fuqizimin e ndjenjës së identitetit dhe vlerave kombëtare të shqiptarëve në diasporë.

Në këtë aktivitetet marrin pjesë Kryeministri, Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme-Ministër përgjegjës për Diasporën, Ministri përgjegjës për Punët e Brendshme, për Financat dhe Ekonominë, Arsimin, Kulturën, Akademia e Shkencave, Dhoma Kombëtare e Tregtisë dhe Industrisë, Radiotelevizioni Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Diasporës, si dhe përfaqësues të Qendrave Kulturore të Diasporës. Presidenti i Republikës, me kërkesën e tij dhe në koordinim me Kryeministrin dhe Ministrin përgjegjës për diasporën, merr drejtimin e mbledhjeve të veçanta të Këshillit Koordinues të Diasporës.

#### **Vizitë në vendin amë**

Organizimi i një vizite me grup të rinj nga komuniteti Arberësh në Itali me qëllim njohjen e tyre me Shqipërinë: gjuhën, traditat, vizitë në objekte kulturore e historike. Mundësimi i kësaj vizite ka për qëllim riaktivizimin e ndjenjës së atdhedashurisë, ndaj rrënjëve të tyre, duke i ardhur në ndihmë vlerës më të madhe që ata mbartin në ruajtjen më së miri prej më shumë se gjysëm shekullisi të gjuhës dhe traditave shqiptare, si dhe shmangien e riskut të asimilimit të kësaj vlere madhore.





## PËRMBYLLJE

Raporti i vitit 2023 është dokumenti gjithëpërfshirës i punës dhe veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Përfundimi i këtij viti, nuk mund të ishte i tillë pa angazhimin e çmueshëm të stafit të Agjencisë, partneritetin e të gjithë aktorëve publik dhe privat, vendas e ndërkombëtar.

Për vitin 2023 vendosim theksin në domosdoshmërinë e realizimit të detyrës me përkushtim, me synim rritjen e bashkëpunimit me Diasporën dhe përfshirjen e saj aktive në këshillim për politikën e brendshme të Qeverisë Shqiptare dhe realizimin e programeve dhe projekteve për forcimin e rolit të saj nëpër botë.